

**Rregullore e punës**  
**e**  
**Komisionit për Buxhet dhe Financa**  
**të**  
**Kuvendit të Republikës së Kosovës**  
**(Periudha e katërt legjislative)**

**I. Dispozitat e përgjithshme**

- Neni 1 Rregullorja e punës
- Neni 2 Fushëveprimi i funksionimit të Komisionit

**II. Kryetari dhe zëvendëskryetarët**

- Neni 3 Emërimi i Kryetarit dhe zëvendëskryetarëve
- Neni 4 Të drejtat dhe detyrat e Kryetarit
- Neni 5 Zëvendësimi i Kryetarit/Roli i zëvendëskryetarëve

**III. Mbledhjet e Komisionit**

- Neni 6 Plani vjetor i punës së Komisionit dhe plani financiar i Komisionit
- Neni 7 Ftesa për mbledhjet e komisionit dhe Rendi i ditës për mbledhjet e Komisionit
- Neni 8 Dokumentet zyrtare të Komisionit
- Neni 9 Gjuha dhe përkthimi
- Neni 10 Kuorumi dhe votimi
- Neni 11 Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit

Neni 12	Mocionet procedurale
Neni 13	Deputetet tjerë që nuk janë anëtarë të Komisionit
Neni 14	Qasja nga publiku dhe mediat
Neni 15	Puna legjislative e Komisionit
Neni 16	Grupet punuese
Neni 17	Dëgjimet e ministrave
Neni 18	Angazhimi i këshilltarëve ose ekspertëve
Neni 19	Mbledhjet e përbashkëta
Neni 20	Dëgjimet publike
Neni 21	Nënkomisionet
Neni 22	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve
Neni 23	Procesverbalet e mbledhjeve

#### **IV. Dispozitat përfundimtare**

Neni 24	Amendamentet
Neni 25	Hyrja në fuqi

## I. Dispozitat e përgjithshme

### Neni 1 (Rregullorja e punës)

1. Në pajtim me nenin 62, par. 2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi) kjo Rregullore e punës përcakton organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).
2. Funksionimi i Komisionit, duke përfshirë edhe këtë Rregullore të punës së Komisionit, i nënshtrohet dispozitave të Rregullores së Kuvendit.

### Neni 2 (Fushëveprimi i funksionimit të Komisionit)

1. Në pajtim me nenin 69, par. 3 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni është komision i përhershëm.
2. Në pajtim me nenin 69, par. 5 dhe nenin 88 të Rregullores së Kuvendit fushëveprimi dhe përgjegjësitë e Komisionit përcaktohen në Shtojcën nr. 2 të Rregullores së Kuvendit. Brenda fushëveprimit dhe përgjegjësiave Komisioni i shqyrton të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me buxhetin dhe me financat publike në Kosovë. Fushëveprimi i këtij komisioni përfshin:
  - shqyrtimin e buxhetit vjetor të Kosovës dhe rishikimin e tij;
  - çështjet buxhetore dhe ato financiare;
  - implikimet buxhetore për vitin e parë dhe për vitet në vazhdim që e shoqërojnë projektligjin dhe bëjnë rekomandime komisionit përkatës funksional;

---

<sup>1</sup> "Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës", versioni i 29 prillit 2010 (Nr. 03 - V - 304).

- shqyrtimin e raporteve periodike të Ministrisë së Financave, për shpenzimet e institucioneve të Kosovës dhe të organizatave buxhetore që i raportojnë Kuvendit;
- raportimin kohë pas kohe, më iniciativën e vet ose me kërkesën e Kuvendit, në seancë plenare për çështjet nga fushëveprimi ose përgjegjësitë e Komisionit;
- shqyrtimin e programit të punës së Qeverisë, mënyrën dhe nivelin e zbatimit të tij në fushën e financave dhe i dhënien e rekomandimeve Kuvendit;
- mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me financat publike;
- bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe me Qeverinë. Ministria e Financave është e obliguar t'i raportojë dhe t'i ofrojë Komisionit të gjitha informatat përkatëse të kërkuara nga ana e tij, duke përfshirë edhe raportimet e drejtpërdrejta nga Ministri i Financave;
- shqyrtimin e legjislacionit në fushat që lidhen me lëmin e buxhetit dhe të financave;
- të drejtën për të iniciuar dhe hartuar projektligje;
- shqyrtimin e projektligjeve dhe të mocioneve lidhur me implikimet dhe koston buxhetore për veprimtarinë e përgjithshme në Kuvend dhe në institucionet e tjera të Kosovës, që lidhen me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e tij;
- Komisioni ushtron edhe veprimtari tjera të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit;

- Komisioni po ashtu shqyrton çështje tjera të përcaktuara në Rregulloren e punës së Kuvendit dhe çështjet të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit parashtrohen para këtij Komisioni.
3. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me ministritë përgjegjëse për institucionet specifike dhe të gjitha ministritë tjera prej të cilave Komisioni ka të drejtë të kërkojë informata dhe të dhëna, duke përfshirë edhe raportimin e drejtpërdrejtë nga ministrat përkatës dhe/ose zyrtarët tjerë.

## **II. Kryetari dhe zëvendëskryetarët**

### **Neni 3 (Emërimi i Kryetarit dhe zëvendëskryetarëve)**

Në pajtim me nenin 63 dhe 69, par. 8 dhe par. 9 të Rregullores së Kuvendit, Kryetari dhe zëvendëskryetari i parë dhe i dytë caktohen nga Kryesia.

### **Neni 4 (Të drejtat dhe detyrat e Kryetarit)**

1. Në pajtim me nenin 65, par. 6 të Rregullores së Kuvendit, dispozitat për autoritetin e Kryetarit të Kuvendit të cilat dalin nga Rregullorja e Kuvendit zbatohen përshtatshëmrisht për Kryetarin e Komisionit.
2. Kryetari përcakton datën e mbledhjeve të Komisionit brenda kornizës së miratuar nga Kryesia, përveç nëse Komisioni paraprakisht ka vendosur në lidhje me këtë çështje. Data e mbledhjes së Komisionit ndryshohet, nëse një gjë e tillë kërkohet nga Kryetari i Kuvendit, Kryesia, një ose më shumë grupe parlamentare apo një e treta (1/3) e Komisionit.

3. Kryetari përgatit rendin e ditës për mbledhjen e Komisionit në pajtim me planet e punës së Komisionit dhe Kuvendit dhe me Rregulloren e Kuvendit, si dhe me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.
4. Kryetari thërret mbledhjet e Komisionit, fton përfaqësuesit e institucioneve për të raportuar dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për të paraqitur dëshmi ose dokumente të rëndësishme.
5. Kryetari udhëheq mbledhjet e Komisionit. Gjatë mbledhjeve të Komisionit, Kryetari u jep fjalën anëtarëve tjerë të Komisionit dhe përfaqësuesve të ftuar të institucioneve tjera duke pasur parasysh radhën e kërkesave të tyre për të marrë fjalën.
6. Nëse është e pamundshme të mbahet mbledhja e Komisionit në formë të duhur, Kryetari mund të anulojë ose në marrëveshje me zëvendëskryetarët ta shtyjë mbledhjen e Komisionit dhe të përcaktojë se kur ajo i rifillon punimet.
7. Kryetari e shtynë mbledhjen e Komisionit, nëse
  - nuk ka kuorum për të votuar gjatë mbledhjes së Komisionit, në pajtim me nenin 9 të Rregullores së Kuvendit;
  - në debat ose para votimit, Komisioni vendos se duhet të kërkohet mendimi i ekspertëve të pavarur, Shërbimit Legjislativ dhe Ligjor, ose Qeverisë;
  - shumica e anëtarëve të Komisionit e vendosin një gjë të tillë me anë të votimit.
8. Kryetari e anulon mbledhjen e Komisionit, nëse para votimit së paku një e treta (1/3) e anëtarëve të Komisionit shprehin nevojën për konsultime.
9. Në koordinim me dy zëvendëskryetarët, Kryetari përcakton anëtarët e grupeve punuese të Komisionit, në pajtim me nenin 16 të kësaj Rregulloreje të punës.

10. Kryetari siguron mbarëvajtjen e mbledhjes. Gjatë mbledhjes së Komisionit, Kryetari është përgjegjës për interpretimin e kësaj Rregulloreje të punës së Komisionit dhe Rregullores së Kuvendit.
11. Kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarët dhe koordinatorin e komisionit, administron me buxhetin vjetor të ndarë për komisionin, në pajtim me Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës<sup>2</sup>

#### **Neni 5 (Zëvendësimi i Kryetarit/Roli i zëvendëskryetarëve)**

1. Në mungesë të Kryetarit të Komisionit, zëvendëskryetari i parë dhe i dytë përkatësisht kryejnë detyrat e Kryetarit, në pajtim me nenin 4, par. 1 deri në par. 8 dhe par. 10 të kësaj Rregulloreje të punës së Komisionit.
2. Në rast të mungesës së Kryetarit dhe të dy zëvendëskryetarëve, anëtari më i moshuar i Komisionit, i pranishëm në mbledhjen e Komisionit, kryen detyrat e Kryetarit në pajtim me nenin 5, par. 1 të kësaj Rregulloreje të punës.

### **III. Mbledhjet e Komisionit**

#### **Neni 6 (Plani vjetor i punës dhe Plani financiar i Komisionit)**

Në fillim të çdo viti kalendarik, Komisioni përcakton orarin e tij të punës në pajtim me Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Planin Vjetor të Punës së Kuvendit, si dhe harton planin për burimet e tij financiare në pajtim me nenin 3

---

<sup>2</sup> “Udhëzimi për Administrimin e Buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, versioni i datës 19 prill 2011 (Nr. 04-V-025).

të Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës Të dyja planet duhet të miratohen nga Komisioni.

### **Neni 7 (Ftesa për mbledhjet e Komisionit dhe Rendi i ditës për mbledhjet e Komisionit)**

1. Në pajtim me nenin 64, par. 5 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni mblidhet së paku dy herë në muaj.
2. Për çdo mbledhje të Komisionit, Kryetari dërgon ftesë në formë të shkruar. Në pajtim me nenin 64, par. 4 të Rregullores së Kuvendit, ftesa u dërgohet anëtarëve të Komisionit dhe përfaqësuesve të institucioneve që do të raportojnë, jo më vonë se katër (4) ditë pune para datës së mbledhjes së Komisionit.
3. Mbledhja e jashtëzakonshme e Komisionit caktohet për terminin më të hershëm të mundshëm i cili mundëson organizimin e mbledhjes së Komisionit në mënyrë të duhur. Ftesa, së bashku me dokumentet tjera përkatëse për takimin e jashtëzakonshëm të Komisionit dërgohen sa më shpejt të jetë e mundur.
4. Kryetari thërret mbledhjen e Komisionit, nëse një e treta (1/3) e anëtarëve të Komisionit kërkojnë mbledhje duke cekur arsyen e kërkesës për mbajtjen e mbledhjes.
5. Ftesa për çdo mbledhje të Komisionit përfshin rendin e ditës për mbledhjen përkatëse dhe të gjitha dokumentet tjera për atë mbledhje.
6. Për ndryshimin e rendit të ditës të mbledhjes së Komisionit anëtarët e Komisionit njoftohen me shkrim, jo më vonë se dy (2) ditë para datës së mbledhjes së



Komisionit. Me njoftimin për ndryshimin e rendit të ditës, Kryetari jep arsyen për një ndryshim të tillë.

7. Rendi i ditës për mbledhjen e Komisionit mund të ndryshohet përmes vendimit të Komisionit në fillim të mbledhjes së Komisionit. Një pikë e rendit të ditës mund të largohet nga rendi i ditës përmes shumicës së votave të anëtarëve të Komisionit në fillim të mbledhjes së Komisionit, përderisa njëkohësisht vendoset për datën e re për shqyrtimin e asaj pike. Në fillim të mbledhjes së Komisionit, një pikë mund të shtohet në rend të ditës me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit. Në të dyja rastet sponsoruesi i propozimit për ndryshimin e rendit të ditës duhet të paraqesë arsyetimin për këtë.
8. Pikat e rendit të ditës për mbledhjen e Komisionit shqyrtohen sipas radhës së përcaktuar në ftesën për mbledhjen e Komisionit. Radhitja e pikave në rend të ditës mund të ndryshojë me propozim të Kryetarit ose cilitdo anëtar të Komisionit, me kusht që propozimi të mos kundërshtohet nga një e treta (1/3) e anëtarëve të pranishëm të Komisionit.
9. Me propozimin e një të tretës së anëtarëve të Komisionit, Komisioni mund të votojë për kufizimin e kohës për debat për pika të caktuara të rendit të ditës.
10. Pikat e shqyrtuara të rendit të ditës mund të shtyhen për mbledhjen e ardhshme të Komisionit, nëse anëtarët e Komisionit përcaktojnë se ka nevojë për debat apo informata shtesë.

## **Neni 8 (Dokumentet zyrtare të Komisionit)**

1. Çdo dokument zyrtar për Komisionin i dorëzohet Njesisë për Mbështetjen e Komisionit jo më vonë se pesë (5) ditë pune para datës së mbledhjes së Komisionit, në të cilin dokumenti zyrtar për Komisionin duhet të shqyrtohet.
2. Dokumentet shtesë zyrtare për Komisionin, për zgjerimin e rendit të ditës duhet të dorëzohen jo më vonë se dy (2) ditë para datës së takimit të Komisionit. Dokumentet zyrtare për Komisionin për mbledhje të jashtëzakonshme të Komisionit duhet të dorëzohen me kohë.
3. Në pajtim me nenin 79 të Rregullores së Kuvendit, secili dokument zyrtar i Komisionit dorëzohet në dy (2) gjuhët zyrtare: gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Anëtarët e Komisionit të cilët i përkasin komuniteteve tjera joshqiptare dhe joserbe mund të dorëzojnë dokumentet në gjuhën e tyre, përkthimi në gjuhën shqipe dhe serbe për anëtarët tjerë të Komisionit do të sigurohet sipas kërkesës. Çdo dokument zyrtar i Komisionit dorëzohet në formë të printuar dhe elektronike.

## **Neni 9 (Gjuha dhe përkthimi)**

1. Në pajtim me nenin 78 të Rregullores së Kuvendit, mbledhjet e Komisionit mbahen në gjuhën shqipe dhe serbe, ndërsa përkthimi sigurohet sipas nevojës.
2. Deputetët e Kuvendit që nuk i përkasin komunitetit shqiptar apo serb kanë të drejtë t'i drejtohen Komisionit në gjuhën e tyre. Në rastet e tilla, për anëtarët e tjerë të Komisionit, sigurohet përkthimi në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe sipas nevojës.

## **Neni 10 (Kuorumi dhe votimi)**

1. Mbledhjet e Komisionit kanë kuorum kur janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve të Komisionit. Vendimet në mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme, nëse më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit kanë qenë të pranishëm në kohën e marrjes së vendimit.
2. Votimi bëhet në mënyrë të hapur, d.m.th përmes ngritjes së dorës “për”, “kundër”, dhe “abstenimit”. Kryetari shpall rezultatin pas përfundimit të votimit.

## **Neni 11 (Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit)**

1. Secili anëtar i Komisionit kontribuon në mënyrë aktive në punën e Komisionit dhe në punën e grupit punues përkatës.
2. Secili anëtar i Komisionit mund të flet për çdo pikë të rendit të ditës gjatë mbledhjeve të Komisionit me kusht që paraprakisht të ketë kërkuar dhe Kryetari t'ia ketë dhënë fjalën.
3. Secili anëtar i Komisionit respekton radhën e folësve dhe i lejon anëtarëve tjerë të Komisionit për të përfunduar fjalën e tyre pa ndërprerje. Kryetari siguron që secili anëtar i Komisionit mund ta ushtrojë të drejtën e tij për të marrë fjalën.
4. Fjala e anëtarëve të Komisionit duhet t'i referohet pikës së rendit të ditës që është duke u shqyrtuar, duhet të jetë objektive dhe nuk duhet të tejkalojë një periudhë të arsyeshme kohore. Kryetari mund t'ia tërheq një anëtar të drejtën për të marrë fjalën, në rast se kontributi i atij anëtari të Komisionit nuk i referohet pikës së rendit të ditës që është duke u diskutuar.

5. Secili anëtar i Komisionit ka të drejtë të përgjigjet në komentet e anëtarëve tjerë, nëse ato i referohen fjalës së tij dhe/ose komentet e tyre shfaqim shenja të keqkuptimit ose keqinterpretimit të fjalës së atij anëtari. Anëtarit i jepet fjala menjëherë pas kërkesës.

### **Neni 12 (Mocionet procedurale)**

1. Secili anëtar i Komisionit mund të paraqesë mocione procedurale për zbatimin ose shkeljen e mundshme të kësaj Rregullore të punës.
2. Anëtarit të Komisionit i cili paraqet mocion procedural me kërkesë i jepet fjala menjëherë për të shpjeguar mocionin brenda një periudhe të arsyeshme.
3. Kryetari mund të mos i jep të drejtën anëtarit të Komisionit për të marrë fjalën ose ia tërheq të drejtën për të folur, në rast se ai keqpërdor mocionin procedural.
4. Mocioni procedural duhet të përfshijë një propozim, i cili votohet pa debat.

### **Neni 13 (Deputetet tjerë që nuk janë anëtarë të Komisionit)**

1. Në pajtim me nenin 21, par. 5 të Rregullores së Kuvendit, deputetët e Kuvendit të cilët nuk janë anëtar të Komisionit, mund të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit në çfarëdo kohe.
2. Siç u përcaktua në par. 1 të këtij neni, deputetëve të Kuvendit u jepet fjala me kërkesë të tyre, por ata nuk kanë të drejtë vote në Komision. Dispozitat e nenit 11, par. 2 deri në par. 5 të kësaj Rregulloreje të punës janë të aplikueshme për anëtarët e tillë përkatësisht.

#### **Neni 14 (Qasja nga publiku dhe mediat)**

1. Në pajtim me nenin 65, par. 1 të Rregullores së Kuvendit, mbledhjet e Komisionit janë në parim të hapura për publikun; përjashtimet aplikohen në pajtim me nenin 65, par. 1 të Rregullores së Kuvendit.
2. Ftesat për mbledhjet e Komisionit duhet të publikohen. Pjesëmarrja e vizitorëve dhe përfaqësuesve të mediave mund të varet nga kapaciteti i vendeve të disponueshme gjatë mbledhjes së Komisionit. Të gjithë vizitorët duhet të regjistrohen nga Njësia për Mbështetje të Komisionit jo më vonë se një (1) ditë para mbajtjes së mbledhjes së Komisionit.
3. Të gjithë vizitorët duhet të ulën në ulëset e përcaktuara para fillimit të mbledhjes së Komisionit. Përfaqësuesit e mediave mund të vendosin kamerat dhe mjetet për incizim në pjesën e përcaktuar në sallën e mbledhjes së Komisionit. Vizitorët dhe përfaqësuesit e mediave mund të vëzhgojnë mbledhjen e Komisionit dhe nuk duhet të ndërhyjnë në rrjedhën e saj.

#### **Neni 15 (Puna legislative e Komisionit)**

1. Në pajtim me nenin 62, par. 1 Komisioni procedon pa vonesë çështjet që i parashtrihen.
2. Në pajtim me nenin 67 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i raporton Kuvendit për çështjet e referuara atij. Raportet e Komisionit për Kuvendin bëhen me shkrim dhe duhen t'i përmbajnë rekomandimet e Komisionit për Kuvendin, së bashku me arsyetimin përkatës. Raportet mund të plotësohen me gojë nga Kryetari ose një anëtar i Komisionit. Komisioni i rekomandon Kuvendit vendimet përfundimtare në

lidhje me çështjet ose punët e referuara atij ose pyetjet e ndërlidhura drejtpërdrejtë me to.

3. Në pajtim me nenin 56, par. 2, Komisioni i shqyrton në parim projektligjet për të cilat, në pajtim me nenin 68 të Rregullores së punës të Kuvendit, është përcaktuar të jetë komision funksional raportues, para shqyrtimit të parë të një projektligji në seancë plenare. Komisioni i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për miratim ose për mosmiratim të projektligjit.
4. Në pajtim me nenin 57, par. 1 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni, në cilësinë e komisionit të përhershëm, shqyrton çdo projektligj pas miratimit të tij në shqyrtim të parë.
5. Propozimet për amendamente në projektligje, në pajtim me nenin 57, par. 3 të Rregullores së Kuvendit, mund të bëhen nga ana e Komisionit brenda dy (2) javësh pune nga data e miratimit të projektligjit në parim dhe duhet t'i adresohen komisionit përgjegjës raportues. Në pajtim me nenin 57, par. 4 të Rregullores së Kuvendit, propozimet për ndryshime duhet të përmbajnë një referencë dispozitës së projektligjit, formulim të saktë të amendamentit dhe arsyetimin për amendamentin e propozuar.
6. Në pajtim me nenin 57, par. 5 të Rregullores së Kuvendit, për propozimet e komisioneve tjera që kanë implikime buxhetore, Komisioni duhet të deklarohet me raport, në afat prej pesë (5) ditëve të punës nga dita e pranimit të tyre.
7. Në pajtim me nenin 57, par. 6 të Rregullores së Kuvendit, në rastet kur Komisioni është komision përgjegjës raportues, atëherë ai duhet t'i prezantojë Kuvendit, brenda dy (2) muajsh pas shqyrtimit të parë, një raport me rekomandime për

projektligjin. Zgjatja e këtij afati mund të kërkohet në pajtim me nenin 57, par. 1 të Rregullores së Kuvendit.

8. Në pajtim me nenin 57, par. 8 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni duhet t'ia prezantojë raportet e tij komisionit funksional brenda dhjetë (10) ditësh nga data e pranimet të amendamenteve nga komisioni përkatës funksional.
9. Në pajtim me nenin 57, par. 9 të Rregullores së Kuvendit, në ato raste kur Komisioni është komision përgjegjës raportues, pasi të ketë përfunduar shqyrtimin e ligjit ai duhet t'ia dorëzojë Kuvendit raportin me rekomandime, së paku pesë (5) ditë pune para shqyrtimit të dytë në Kuvend. Raporti po ashtu duhet të përmbajë edhe mendimet e komisioneve tjera të përhershme si dhe një përmbledhje të amendamenteve të propozuara nga deputetët e Kuvendit, nga Komisionet, grupet parlamentare ose nga Qeveria.
10. Komisioni mund të kërkojë informata dhe/ose dokumente nga komisionet tjera të Kuvendit dhe në pajtim me nenin 65, par. 5 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni mund t'u ofrojë komisioneve tjera informata ose dokumente, nëse ato e kërkojnë këtë prej tij.

### **Neni 16 (Grupet punuese)**

1. Për shqyrtimin vjetor të projektbuxhetit, Komisioni themelon grupe punuese. Grupi punues përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë të Komisionit. Në koordinim me dy zëvendëskryetarët, Kryetari përcakton përbërjen e grupit punues në pajtim me parimin e përfaqësimit të barabartë të koalicionit dhe partive opozitare brenda

grupeve punuese. Secili anëtar i Komisionit mund të jetë anëtar i më shumë së një (1) grupi punues.

2. Secili grup punues caktohet për tërë kohëzgjatjen e periudhës legjislative. Secili grup punues duhet të jetë përgjegjës për një pjesë të projektbuxhetit të përcaktuar në mënyrë të qartë, ku të gjitha grupet punuese mbulojnë plotësisht tërë projektbuxhetin.
3. Secili grup punues duhet të shqyrtojë me kujdes pjesën e projektbuxhetit që është nën përgjegjësinë e tij dhe t'ia raportojë të gjeturat e tij Komisionit, duke dhënë rekomandimet dhe propozimet e tij për amendamente. Secili anëtar i grupit punues, me kërkesën e tij mund të merr pjesë në punën e grupit tjetër punues.
4. Parimet e funksionimit të Komisionit janë njëjtë të vlefshme për funksionimin e grupeve punuese.
5. Përveç shqyrtimeve vjetore të projektbuxhetit, grupet punuese duhet të vlerësojnë projektligjet, raportet dhe/ose çështjet tjera brenda fushëveprimit të tyre, të cilat i referohen Komisionit .Grupet punuese hartojnë raportin me të gjeturat e tyre, japin rekomandime dhe amendamente, të cilat ia dorëzojnë Komisionit për shqyrtim në mbledhjen e Komisionit. .
6. Për organizimin e mbledhjeve të grupeve punuese jashtë selisë së Kuvendit, aplikohen udhëzimet procedurale dhe financiare të nxjerra nga Kryesia e Kuvendit në Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.



### **Neni 17 (Dëgjimet e ministrave)**

1. Në pajtim me nenin 65, par. 2 të Rregullores së Kuvendit, gjatë shqyrtimit të projektligjit, Komisioni e fton ministrin e Ministrisë përkatëse për të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit. Ministri ose përfaqësuesi i tij është i obliguar të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit. Ata kanë të drejtën e paraqitjes së propozimeve gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjit.
2. Në mungesë të përfaqësimit adekuat të ministrisë ose në rast të mungesës së përfaqësuesit të ministrisë, në pajtim me nenin 7, par. 10 të kësaj Rregulloreje të punës, Kryetari mundet të heq nga rendi i ditës atë pikë të rendit të ditës ose të shtyjë shqyrtimin e asaj pike dhe të vendosë se kur do të rifillojë diskutimin.
3. Ministria e Financave mund të dërgojë një përfaqësues të përhershëm në të gjitha mbledhjet e Komisionit.

### **Neni 18 (Angazhimi i këshilltarëve ose ekspertëve)**

1. Në pajtim me nenin 65, par. 3 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni mund të angazhojë këshilltarë ose ekspertë.
2. Udhëzimet procedurale dhe financiare të nxjerra nga Kryesia në Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës aplikohen me rastin e angazhimit të këshilltarëve dhe ekspertëve.

### **Neni 19 (Mbledhjet e përbashkëta)**

Në pajtim me nenin 65, par. 5 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni mund të mbajë mbledhje të përbashkëta me komisione tjera të Kuvendit.

## **Neni 20 (Dëgjimet publike)**

1. Në pajtim me nenin 66 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni mund të mbajë dëgjime publike për qëllim të njoftimit me informata për çështjen që është duke u shqyrtuar.
2. Për këtë qëllim, Komisioni mund të ftojë ekspertë, organizata publike, përfaqësues të grupeve të interesit dhe persona tjerë. Komisioni mund të hyj në diskutim të përgjithshëm me personat që i japin këto informata për atë që është e nevojshme për të sqaruar faktet.
3. Udhëzimet procedurale dhe financiare të nxjerra nga Kryesia në Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës aplikohen me rastin e organizimit të dëgjimeve publike.

## **Neni 21 (Nënkomisionet)**

Në pajtim me nenin 70 të Rregullores së Kuvendit, për detyra specifike, Komisioni mund të formojë nënkomisione me anëtarët e vet. Për këtë qëllim zbatohen dispozitat e përcaktuara në nenin 70 të Rregullore së Kuvendit.

## **Neni 22 (Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve)**

1. Në pajtim me nenin 73 të Rregullores së Kuvendit, brenda fushës së përgjegjësie të tij, Komisioni është i autorizuar ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit nga Qeveria, përkatësisht nga ministria.
2. Përzgjedhja e ligjit për mbikëqyrje nga Komisioni i nënshtrohet debatit në mbledhjen e Komisionit.

3. Ministria përkatëse i raporton Komisionit pa kërkesë, së paku një herë në vit, në lidhje me zbatimin e ligjit.
4. Për ta ushtruar autoritetin e lartpërmendur, Komisioni:
  - a) kontrollon dhe studion efektivitetin e ligjeve në fuqi në kuadër të fushëveprimit të tij, zbatimin e tyre dhe propozon masa për rastet konkrete;
  - b) përpilon listën, që përmban: datën e shpalljes së ligjit, datën e publikimit të ligjit në Gazetën Zyrtare, listën e dispozitave të ligjit, që duhet të zbatohen nga Qeveria, listën e vendimeve të Qeverisë për zbatimin e këtyre dispozitave;
  - c) bën kontrollimin e veprimtarisë së përgjithshme të ministrisë përkatëse; dhe
  - d) raporton me shkrim dhe me gojë një herë në vit në seancat plenare të Kuvendit.
5. Nëse ministria nuk raporton ose nëse raportimi i saj konsiderohet jo i plotë, me kërkesë të Komisionit çështja hyn në rendin e ditës së seancës së ardhshme plenare.
6. Për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve aplikohen udhëzimet procedurale dhe financiare të nxjerra nga Kryesia në Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **Neni 23 (Procesverbalet e mbledhjeve)**

1. Një përmbledhje e diskutimit të pikave të rendit të ditës së Komisionit, lista e pjesëmarrësve në mbledhje, votat e anëtarëve të Komisionit dhe rezultatet e përgjithshme të votimit, si dhe të gjitha njoftimet në lidhje me punën e Komisionit regjistrohen në Procesverbalin e çdo mbledhjeje të Komisionit.

2. Procesverbali i mbledhjes votohet pa vonesë në fillim të mbledhjes së radhës të Komisionit. Procesverbali i mbledhjes vihet në dispozicion të publikut.
3. Kryetari mund të kërkojë nga Njësia për mbështetjen e Komisionit të mbaj shënime për raportet e kërkuara dhe të dorëzuara, si dhe orarin përkatës.

#### **IV. Dispozitat përfundimtare**


##### **Neni 24 (Amendamentet)**

1. Secili anëtar i Komisionit mund t'i propozojë Kryetarit amendamente për ndryshimin e kësaj Rregulloreje të punës.
2. Të gjitha amendamentet në këtë Rregullore të Punës duhet të jenë në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe duhet të miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit pas shqyrtimit të tyre në mbledhjen e Komisionit.
3. Në rast të ndryshimeve në ose miratimit të versionit të ri të Rregullores së Kuvendit, Komisioni duhet të themelojë një grup punues të përbërë prej katër (4) anëtarëve dhe Koordinatorit të Njesisë për mbështetje Komisionit. Grupi punues duhet të propozojë amendamentet e nevojshme për ndryshimin e kësaj Rregulloreje të punës së Komisionit në pajtim me ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit.

## **Neni 25 (Hyrja në fuqi)**

1. Kjo Rregullore e punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa hyn në fuqi pas miratimit të saj me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe postimit në faqen e internetit të Kuvendit.
2. Kjo Rregullore e punës vlen për Komisionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Buxhet dhe Financa për periudhën katërt (4) legislative.

Prishtinë, 25.11.2011

  
Safete Hadërgjonaj

- Kryetare -

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Kuvendi i Republikës së Kosovës